

## NJOFTIM

### **Për përfituesit / institucionet financiare për garancinë bankare**

#### **Pagesat paraprake 50% e ndihmës publike (Grant)**

Ju informojmë se bazuar në Marrëveshjen Sektoriale, e ndryshuar të ratifikuar, Shtojca 2 e Marrëveshjes Sektoriale, "Kuari i Kontrollit të Brendshëm, Seksioni 3, Aktivitetet e Kontrollit, Dispozitat e përgjithshme plotësuese të Seksionit 3 të Shtojcës B të Marrëveshjes Kuadër, pika 3, "Procedura për parapagesat dhe garancitë ", është aprovuar për zbatimin e Programit IPARD 2014-2020, nën **Thirrjen 2**.

**Pagesa paraprake e përfituesit cilësohet nga autoriteti kontraktues si shpenzim i pranueshëm deri në 50% të ndihmës publike lidhur me projektin, e cila do të nënshtrohet vendosjes së një garancie bankare ose ekuivalente me të (me vlefshmëri të paktën 6- muaj pas datës së përfundimit të investimit të përcaktuar në kontratë), që do të korrespondojë 110 % të shumës parapaguar, sipas kushteve të mëposhtme:**

- **Pagesat paraprake lidhur me projektin:**

- deri më 20% të ndihmës publike,
- që nuk kalojnë shumën 100.000 euro,

janë të pranueshme dhe do t'i nënshtrohen vendosjes së një garancie bankare apo garancie ekuivalente me këtë të fundit (policë sigurimi).

- **Pagesat paraprake lidhur me projektin, kur:**

- përbëjnë nga 20% deri në 50% të ndihmës publike,
- dhe/ose kur kalojnë vlerën 100.000 euro,

janë të pranueshme, por do t'i nënshtrohen vetëm vendosjes së një garancie bankare.

Afati i vlefshmërisë së garancisë bankare është 6 muaj nga përfundimi i afatit të zbatimit të investimit sipas Kontratave individuale me përfituesit.

Garancia e paraqitur do të kontrollohet për vlefshmërinë nga Agjencia IPARD me kërkesë të thjeshtë për institucionet që lëshojnë dokumentin.

**Kjo procedurë do jetë e aplikueshme vetëm për përfituesit që janë kontraktuar nën thirrjen II, të cilët do të ftohen për kryerjen e amendimit të kontratave si dhe aplikantët nën këtë thirrje që do të kontraktohen në vijim.**

**Dokumentat që praqiten pranë AZHBR janë:**

- Kërkesë me shkrim për pagesën paraprake;

- Garancia bankare ose garancia e sigurimit të kontratës;
  - Dokument identifikimi i vlefshëm;
  - Numri i Llogarisë bankare (IBAN) sipas Kontratës;
- Në rast se ka ndryshim të të dhënave bankare apo informacione të përfituesit duhet të bëhet Njoftim me Shkrim për Autoritetin Kontraktor, AZHBR.

**<AGJENCIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
Rruga Muhamet Gjollësia Nr.56  
1001 Tiranë, Shqipëri>**